

LIGJ
Nr, 7584, datë 14.7.1992

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7543, DATË 24.12.1991 "PËR TATIMIN MBI QARKULLIMIN E MALLRAVE"

Në mbështetje të neneve 13 dhe 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Në ligjin nr.7543, datë 24.12.1991 "Për tatimin mbi qarkullimin e mallrave", bëhen këto ndryshime :

Neni 1

Në nenin 1, pas fjalës "fizike" shtohen edhe fjalët "vendas dhe të huaj".

Neni 2

Neni 2 ndryshohet si vijon :

"Tatimi mbi qarkullimin e mallrave zbatohet për të gjitha shitjet me shumicë të mallrave në Republikën e Shqipërisë, pavarësisht nëse mallrat prodhohen brenda vendit apo importohen.

Për mallrat e importuara tatimi mbi qarkullimin paguhet menjëherë me pagimin e taksës doganore, pavarësisht nga koha e shitjes së tyre.

Nuk zbatohet tatimi mbi qarkullimin për mallrat që eksportohen, me përjashtim të energjisë elektrike dhe të disa mineraleve që përcaktohen nga Ministria e Financave dhe e Ekonomisë, në bashkëpunim me Ministrinë e Industrisë, të Burimeve Minerare dhe Energjetike.

Për mallrat e importit që ndërmarrjet importuese të ministrive e institucioneve të tjera qendrore u shesin bazave të furnizimit materialo-teknik nuk aplikohet tatimi mbi qarkullimin. Për çdo shitje të mëvonshme pas kësaj hallke do të zbatohet tatimi mbi qarkullimin".

Neni 3

Në nenin 3, në paragrafin e parë hiqen fjalët "në çmimin e shitjes".

Në nenin 3, paragrafi i dytë ndryshohet si vijon:

"Disa nga ndërmarrjet e industrisë nxjerrëse të mineraleve e të naftës, që për gjashtëmujorin e parë të vitit 1992 kanë paguar tatimin mbi qarkullimin në masën 1 %, sipas përcaktimit të Ministrisë së Industrisë, të Burimeve Minerare e Energjetike, për gjashtëmujorin e dytë të vitit 1992 do të paguajnë tatim në masën 10 % dhe për vitin 1993 e në vazhdim 15 % .

Nuk aplikohet tatim mbi qarkullimin për makineritë e veglat bujqësore që vijnë me kredi nga importi.

Personat juridikë me pjesmarrje jo më pak se 1/3 e kapitalit të huaj, ose me kapital plotësisht të huaj, paguajnë tatim mbi qarkullimin në masën 5 % .

Neni 4

Neni 4 ndryshon si vijon :

"Për mallrat që prodhohen brenda vendit, tatimi mbi qarkullimin e mallrave llogaritet në bazë të vlerës së çdo sasive malli të shitur dhe detyrimi për pagimin e tatimit mbi qarkullimin e mallrave fillon nga koha ku shitësi nis faturën në adresë të blerësit.

Neni 5

Në nenin 5 fjalët "të vlerës së doganuar" zëvendësohen me fjalët "të vlerës doganore".

Neni 6

Neni 6 ndryshohet si vijon :

"Organet doganore detyrohen të bëjnë llogaritjen dhe arkëtimin e tatimit mbi qarkullimin e mallrave që importohen, të cilin e derdhin çdo 5 ditë në buxhetin e shtetit për llogari të organeve tatimore".

Neni 7

Në nenin 8 fjalët "çdo 10 ditë" zëvendësohen me fjalët: "brenda 5 ditëve".

Neni 8

Neni 10 ndryshohet si vijon:

"Shitësit importuesit dhe organet doganore, detyrohen të mbajnë llogari të veçantë për tatimin mbi qarkullimin e mallrave, si dhe të plotësojnë e të dërgojnë në organet tatimore deklaratën periodike mujore mbi tatimin e realizuar e të derdhur, brenda datës 10 të muajit pasardhës".

Neni 9

Në nenin 11, në paragrafin e fundit, pas fjalëve "tatimin erealizuar" shtohen fjalët "dhe të derdhur".

Në këtë nen, pas paragrafit të fundit, shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

"Mosparaqitja në afatin e caktuar e deklaratës vjetore parashikuese mbi qarkullimin e mallrave, që do të kryhet, dënohet me gjobë nga 6000 deri në 8000 lekë".

Neni 11

Në nenin 13, në paragrafin e parë, para fjalës "rreth" shtohen fjalët: "komunë, bashki etj...".

Në paragrafin e dytë, fjalët "te përgjegjësi i seksionit tëfinancës në rreth", zëvendësohen me fjalët "te kryetari i zyrës së tatimeve e taksave në komunë e bashki, te kryetari i degës së tatimeve e taksave në rreth".

Neni 12

Nenet 14 e 15 bashkohen në një nen me nenin 14 si vijon:

"Tatimi mbi qarkullimin e mallrave nuk zbatohet për mallrat,ndaj të cilëve me ligj të veçantë zbatohet akciza, si dhe për disa mallra që caktohen me vendim të Këshillit të Ministrave me propozim të Ministrisë së Financave dhe të Ekonomisë".

Neni 13

Nenet 7 dhe 9 shfuqizohen.

Neni 14

Për mallrat stoqe, gjendje më 31.2.1991 sipas inventarit fizik të ndërmarrjeve shtetërore, të kontrolluar e të miratuar nga zyrat (degët) e tatimeve dhe taksave në komuna, bashki e rrethe të mos zbatohet tatim mbi qarkullimin.

Ky nen ka fuqi vepruese deri më 31.12.1992.

Neni 15

Ky ligj hyn në fuqi 5 ditë pas shpalljes së tij.

Shpallur me dekretin nr.264, datë 20.7.1992 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha.